

INSTRUMENTI 4: NJOFTIMI PËR RASTET E NXËNËSVE, TË CILËT E KANË BRAKTISUR SHKOLLËN

Përmbledhje:			
Instrumenti për	Shkollat	Synimet:	Njoftimi i DKA-së për rastet e fëmijëve, të cilët e kanë braktisur shkollën
Procesi	Shkollat e njoftojnë menjëherë DKA-në, kur nxënësit e braktisin e shkollën, d.m.th. kur nxënësit nuk kanë vijuar mësimin për më shumë se 10 ditë, pa ndonjë arsye të vlefshme.		

SHËNIM: *Nuk ka ndonjë përkufizim zyrtar për “braktisjen” në Kosovë, për të saktësuar që pas sa ditëve fëmije konsiderohet të ketë braktisur shkollën. Rekomandohet, që shkollat të njoftojnë DKA-në, kur fëmijët të kenë munguar më gjatë se 10 ditë, pa ndonjë arsye të vlefshme.*

Lista kontrolluese për shkollën	✓
Shkolla e monitoron vijueshmërinë e secilit nxënës në baza ditore, javore dhe mujore	
Shkolla e lajmëron kujdestrain e klasës, kur fëmije mungon 3 ose më shumë ditë pa ndonjë arsye të vlefshme, brenda një muaji	
Shkolla zbaton ndërhyrjet për të siguruar që fëmije të kthehet në shkollë pas 3 ditë mungese, pa ndonjë arsye të vlefshme (takimi me prindër, puna me ndërmjetuesit në komunitet, puna me punëtorët social kur e nevojshme, biseda me fëmijën, vendosja e kontakteve ndërmjet shkollës, fëmijës dhe familjes, duke i ofruar mbështetje fëmijës në çfarëdo sferë që ka nevojë etj.)	
Shkolla e njofton DKA-në, kur fëmijët mungojnë më gjatë se 10 ditë, pa ndonjë arsye të vlefshme.	
Shkolla e njofton DKA-në, kur fëmije mungon më gjatë se 5 ditë, pa ndonjë arsye të vlefshme dhe kur shkolla ka shqetësime serioze për sigurinë e fëmijës.	

Mungesa	Arsyet
Arsyet e vlefshme	Terminet urgjente mjekësore/stomatologjike Periudhë zie për anëtarët e familjes Sëmundja - në qoftë se ajo zgjat shumë ose në qoftë se ajo shkakton mungesa të rregullta, do të kërkohet një formë e dëshmime mjekësore Respektimi i festave fetare, të dakordoheni paraprakisht me drejtorin e shkollës

Arsyet që nuk janë të vlefshme	Vizita e të afërmëve; festat Ditëlindjet Përkujdesja ndaj vëllezërve/motrave ose kushërijëve Terminet rutinore mjekësore/stomatologjike
--------------------------------	--